

Ministri Ismaili mbledh Këshillin Ndërmnistror për të diskutuar për veprimet e ndërmarra kundër Etheve hemorragjike

Prishtinë, 11 qershor 2019

Nën udhëheqjen e Ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, është mbajtur takimi i radhës i Këshillit ndërmnistror për luftimin dhe parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHCC).

Ministri Ismaili tha se takimi i Këshillit po mbahet me qëllim të përcjelljes sa më të mirë të zbatimit të masave për kontrollin e etheve homorragjike për të ndikuar në uljen e sëmundshmërisë nga kjo sëmundje që shkaktohet si pasojë e pickimit dhe infektimit nga rriqrat.

Ministri Ismaili kërkoi nga të gjitha institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e Planit operativ për parandalimin dhe luftimin e EHCC që ta rrisin angazhimin gjatë kësaj periudhe kur frekuenca e rasteve mund të jetë më e shprehur.

Drejtori i IKSHP-së, Naser Ramadani, tha se në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera po zbatohen aktivitetet e Planit operacional me qëllim të parandalimit dhe luftimit të

EHCC, kurse zyrtarë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe nga Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës njoftuan se në terren po bëhet dezinesktimi i hapësirave bashkë me komunat që njihen si zona endemike (Malishëve, Suharekë, Rahovec e Klinë), si dhe repelimi i kafshëve si masë parandaluese.

Këshilli, gjithashtu, u bën thirrje qytetarëve që të kenë kujdes të shtuar gjatë kësaj sezone duke zbatuar masat e përgjithshme për mbrojtjes nga Ethet Hemorragjike, ndërsa në raste të pickimit nga rriqnat të lajmërohen te mjeku më i afërt në kujdesin primar shëndetësor.